



Raport përfundimtar për auditimin tematik “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2023”

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK
“MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E
PERFORMANCËS TË EVADUAR NË GJASHTË MUJORIN E DYTË TË
VITIT 2023”**

**MBI AUDITIMIN ME TEMË: “EFEKTIVITETI I SISTEMIT PËR MBROJTJEN E
VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE ME FOKUS, GRATË E DHUNUARA”**

NË SUBJEKTET:

- ✓ **MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**
- ✓ **MINISTRIA E DREJTËSISË**
- ✓ **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT**
- ✓ **SHËRBI MI SOCIAL SHTETËROR**
- ✓ **BASHKIA Durrës**
- ✓ **BASHKIA KUKËS**
- ✓ **BASHKIA GJIROKASTËR**

TIRANË, PRILL 2025

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:.....	3
1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh.....	3
3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh.....	4
4. Statusi i pranimet të rekomandimeve.....	4
II. HYRJA.....	4
II.1 Objekti auditimit:.....	5
II.2 Qëllimi auditimit.....	5
II.3 Metodologjia e auditimit:	5
II.4 Konkluzioni.....	5
II.5 Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna.....	6
III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	6
IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	32
V. ANEKSE	36

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), në zbatim të programit të auditimit tematik me nr. 1481 prot., datë 12.12.2024 dhe objekt, “*Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e performancës, evaduar në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023*”, ushtroi auditim subjektet pjesë e Auditimit të Performancës me temë: “*Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus, gratë e dhunuara*”, përkatësisht në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Shërbimin Social Shtetëror si dhe Bashkitë Durrës, Gjirokastrë dhe Kukës.

Auditimi i kryer në vitin 2023, kishte si periudhë auditimi veprimtarinë nga data 01.01.2020 deri më datën 30.06.2023. dhe konkluzionet e tij janë miratuar me **Vendimin nr. 222 datë 21.12.2023 të Kryetarit të KLSH-së** si dhe u janë përcjellë subjekteve të audituar me shkresat nr. 442/25 prot., 442/26 prot., 442/27 prot., 442/28 prot., 442/29 prot., 442/30 prot., 442/31 prot., 442/32 prot., datë 22.12.2023. Auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna u krye nga data 16.12.2024 deri më datë 17.01.2025, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- a. Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- b. Nxjerrjen nga Titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhër për zbatimin e masave organizative;
- c. Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjektet e audituara u mbajtën Akt-Verifikimet përkatësisht:

- Akt-verifikimi nr. 1 datë 16.01.2025, mbajtur për Bashkinë Kukës.
- Akt-verifikimi nr. 2 datë 16.01.2025, mbajtur për Bashkinë Gjirokastrë.
- Akt-verifikimi nr. 3 datë 16.01.2025, mbajtur për Bashkinë Durrës.
- Akt-verifikimi nr. 4 datë 16.01.2025, mbajtur për Ministrinë e Drejtësisë.
- Akt-verifikimi nr. 5 datë 17.01.2025, mbajtur për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- Akt-verifikimi nr. 6 datë 17.01.2025, mbajtur për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Akt-verifikimi nr. 7 datë 17.01.2025, mbajtur për Shërbimin Social Shtetëror.

Projektraporti u është dërguar subjekteve të mësipërm me shkresat përkatëse datë 17.02.2025.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Nga auditimi rezultoi se:

- Bashkia Kukës nuk ka hartuar Program Pune për masat në zbatim të rekomandimeve të lëna, dhe rrjedhimisht nuk ka njoftuar Kontrollin e Lartë të Shtetit.
- Bashkia Gjirokastrë ka njoftuar Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi masat që do të merren për zbatimin e rekomandimeve, me shkresën nr. 12261/1 prot., datë 17.01.2024, regjistruar në KLSH me nr. 442/35 prot., datë 22.01.2024.
- Bashkia Durrës nuk ka njoftuar Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi masat që do ndërmarri referuar afatit të mësipërm.
- Ministria e Drejtësisë nuk ka paraqitur program në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi masat që do ndërmarri brenda afatit të mësipërm. Theksojmë se kjo ministri ka vetëm një masë të adresuar.

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. 777 prot., datë 22.01.2024 ka paraqitur Planin e Veprimit mbi masat që duhet të merren nga strukturat e policisë së shtetit për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, regjistruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr. 442/36 prot., datë 23.01.2024.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 2006/8 prot., datë 23.01.2024, MSHMS ka paraqitur programin e punës mbi masat që duhet të merren nga strukturat përkatëse, regjistruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr. 442/37 prot., datë 25.01.2024.
- Shërbimi Social Shtetëror me shkresën nr. 10186/3 prot., datë 15.01.2024, SHSSH ka paraqitur Planin e Punës mbi masat që duhet të merren nga strukturat përkatëse, regjistruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr. 442/23 prot., datë 17.01.2024.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecures së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna".

Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e këtij afati rezultoi se:

- Bashkia Kukës nuk ka dërguar raportim në KLSH, në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, mbi zbatimin e rekomandimeve.
- Bashkia Gjirokastrë nuk ka dërguar raportim në KLSH, në respektim të afatit ligjor prej 6 muajsh, mbi zbatimin e rekomandimeve.
- Bashkia Durrës ka dërguar raportim në KLSH, mbi zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 7473 prot., datë 13.06.2024, regjistruar në KLSH me nr. 442/38 prot., datë 18.06.2024.
- Ministria e Drejtësisë nuk ka paraqitur informacion në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi masat që janë ndërmarrë brenda fatit të mësipërm. Theksojmë se kjo ministri ka vetëm një masë të adresuar.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 3330 prot., datë 26.07.2024, ka paraqitur informacion mbi masat që janë ndërmarrë, regjistruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr. 442/40 prot., datë 31.07.2024.
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nuk ka paraqitur informacion në Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi masat që janë ndërmarrë brenda fatit të mësipërm.
- Shërbimi Social Shtetëror me shkresën nr. 4754 prot., datë 18.06.2024, ka paraqitur informacion mbi masat që janë ndërmarrë, regjistruar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me shkresën nr. 442/39 prot., datë 24.06.2024. Në vijim me SHSSH me shkresën nr. 9512 prot., datë 10.12.2024 regjistruar në KLSH me nr. 442/41 prot., datë 13.12.2024 ka përcjellë ecurinë vijuese të rekomandimeve të lëna.

3. Statusi i pranimit të rekomandimeve:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 442/25 prot., 442/26 prot., 442/27 prot., 442/28 prot., 442/29 prot., 442/30 prot., 442/31 prot., 442/32 prot., datë 22.12.2023, janë rekomanduar gjithsej 24 masa:

Masa për ndryshime ligjore apo përmirësime ligjore, 3 rekomandime.

Masa organizative, 21 rekomandime.

Sipas masave të marra nga institucionet respektive, shkresave të përcjella në KLSH mbi planin e masave si dhe shpjegimet e paraqitura për secilin rekomandim në fazën e verifikimit të tyre, rezultoi se:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Masa për ndryshime ligjore apo përmirësime ligjore	3	3	0
2	Masa organizative	21	21	0

II. HYRJA

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimet e evaduar në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023, është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe Manualin “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve” miratuar me shkresën nr. 341/17 prot., datë 23.06.2020. Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit nr. 1481 prot., datë 12.12.2024. Rekomandimet e lëna në Raporti Përfundimtar i Auditimit të mëparshëm me temë, “*Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus, gratë e dhunuara*”, me konkluzionet përkatëse janë miratuar me **Vendimin nr. 222 datë 21.12.2023 të Kryetarit të KLSH-së**, dhe janë përcjellë në subjektet e audituara me shkresat nr. 442/25 prot., 442/26 prot., 442/27 prot., 442/28 prot., 442/29 prot., 442/30 prot., 442/31 prot., 442/32 prot., datë 22.12.2023.

Auditimi u krye nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH-së, me përbërje:

1. K. Xh., përgjegjës grupi,
2. B. L., anëtar,
3. A. Ç., anëtare,
4. R. L., anëtar.

Auditimi ka filluar më, 16.12.2024

Auditimi ka përfunduar më, 17.01.2025

II.1. Objekti i auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimin Social Shtetëror, Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Këshillin e Qarkut Tiranë si dhe Bashkitë Durrës, Gjirokastrë dhe Kukës.

II.2. Qëllimi i auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II.3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektit në të ardhmen.

II.4. Konkluzioni:

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Këshilli i Qarkut Tiranë si dhe Bashkitë Durrës, Gjirokastrë dhe Kukës, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të

lëna nga KLSH-ja me shkresat e sipërcituara, rezulton se 24 (njëzetë e katër) masat e rekomanduara gjithsej janë pranuar plotësisht nga subjektet e audituara.

Nga masa e pranuar:

- janë zbatuar 3 rekomandime ose 13% e tyre,
- janë zbatuar pjesërisht 7 rekomandime ose 29% e tyre,
- gjenden në proces zbatimi 14 rekomandime ose 58% e tyre,
- gjenden pa zbatuar 0 rekomandime.

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore	3		3		
2	Masa organizative	21	3	4	14	
	Gjithsej	24	3	7	14	0

Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet si më poshtë:

Nr.	Statusi i masave Për ndryshim apo përmirësim ligjor	Në numër	Në %
1	Totali	3	100%
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	3	100%
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar Plotësisht		
2	Zbatuar pjesërisht	3	100%
3	Në proces zbatimi		
4	Pa zbatuar		

Nr.	Statusi i masave Organizative	Në numër	Në %
1	Totali	21	100%
2	Pa pranuar		
3	Pranuar	21	100%
	Nga të pranuarat:		Në % ndaj të pranuarave
1	Zbatuar Plotësisht	3	14%
2	Zbatuar pjesërisht	4	19%
3	Në proces zbatimi	14	67%
4	Pa zbatuar		

II.5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Pavarësisht nga puna e bërë dhe masat e marra, niveli i zbatimit të plotë të rekomandimeve është i ulët rreth 13%. Për disa nga masat e lëna (institucionet) nuk kanë mundur realizimin e tyre. Rëndësia dhe ndjeshmëria e temës objekt auditimi kërkon më tepër impenjim nga subjektet e audituara për përmbushjen e rekomandimeve të lëna në drejtim të garantimit të një sistemi sa më të përshtatshëm për mbështetjen e viktimave të dhunës në familje.

III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Nga të dhënat e paraqitura gjatë auditimit prej subjekteve të audituara, përgjigjet me shkrim dhe dokumentacionit të tyre, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1.1 Pyetje e auditimit: A kanë ndikuar pozitivisht masat parandaluese të marra për dhunën ndaj grave në marrëdhëniet familjare ?

1- Gjetje nga auditimi: Legjislacioni ka pasur mangësi në evidentimin e përgjegjësisë të personave që janë pjesë e sistemit të MKR-së për masat parandaluese, por edhe për drejtuesit e pushtetit vendor që nuk përmbushin detyrimet ligjore për rehabilitim e viktimave të dhunës në familje si pjesë e mbrojtjes që parashikohet. Ka munguar gjithashtu bashkëpunimi ndër institucional i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Ministrinë e Brendshme dhe/ose Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për të evidentuar dhe marrë masat e nevojshme sensibilizuese të cilat kanë impakt të lartë social.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të marrin masa për të propozuar ndryshime ligjore ku të kërkohet ashpërsimi i legjislacionit, për vënien përpara përgjegjësisë administrative dhe penale të përfaqësuesve të institucioneve qendrore e vendore, që nuk përmbushin detyrimet ligjore për parandalimin e dhunës në familje dhe masave mbrojtëse, në veçanti kur nga mosveprimet e tyre janë shkaktuar dëmtime të rënda në marrëdhëniet familjare ose viktima.

Brenda datës 30.06.2024

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 06.01.2025 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

MSHMS në bashkëpunim me U... kanë realizuar një Vlerësim të kuadrit ligjor dhe nënligjor për dhunën në marrëdhëniet familjare, drafti i të cilit është dorëzuar në MSHMS për validim.

Një nga konkluzionet paraprake të këtij raporti vlerësimi, i cili ka analizuar të gjithë legjislacionin shqiptar në fuqi duke nisur nga Kodeti dhe deri tek Ligji Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, të para de sipas standardeve të Konventës CEDAW dhe Konventës së Stambollit, është si më poshtë:

Legjislacioni shqiptar është i plotë dhe shterues në lidhje me masat që parashikohen ndaj punonjësve në rastet kur ata nuk i përmbushin detyrimet kundrejt viktimave të dhunës.

Në këtë drejtim nuk ka nevojë për rishikimin e ligjit, por është e rëndësishme të nënvizohet dhe të theksohet domosdoshmëria e përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor ekzistues.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, duke vlerësuar angazhimin institucional të marrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.**

1.2.1 Pyetje e auditimit: Si ka funksionuar përgjigjja dhe menaxhimi i rasteve të dhunës ndaj grave në marrëdhëniet familjare nga institucionet e përfshira?

2- Gjetje nga auditimi: Midis anëtarëve të Ekipit Teknik Ndërdisciplinor që trajton rastet e dhunës në familje dhe Koordinatorëve Vendor në bashki për referimin e rasteve të dhunës, ka munguar ndërveprimi dhe komunikimi i duhur zyrtar në dy drejtime. Së pari, strukturat vendore të policisë së shtetit nuk përcjellin (në të gjitha rastet që referojnë) raportin e vlerësimit të riskut pranë KVDH - së, për arsye se, sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje¹, një kopje e raportit të vlerësimit të riskut i jepet, përveç titullarit të strukturës përgjegjëse (policisë) dhe punonjësve (kryesisht KVDH) që thirren për hartimin e këtij raporti. KVDH nuk ka detyrimin të jetë prezent gjithmonë në momentin e vlerësimit të riskut në polici. Së dyti, evidentohet se referimet e institucioneve të tjera anëtarë të ETN – së janë në nivele minimale, krahasimisht me policinë e shtetit.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale së bashku me Ministrinë e Brendshme të rishikojnë Udhëzimin e Përbashkët nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”, për të përcjellë në çdo rast raportin e vlerësimit të riskut koordinatorit vendor të dhunës në bashki.

Brenda datës 30.06.2024

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 06.01.2025 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Rekomandimi është ende në proces në kuadër të analizës për hartimin e legjislacionit.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, në vijim të masave për hartimin e legjislacionit, Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Nr. 39, datë 24.01.2024, “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit Teknik ndërinstitucional të punës për hartimin e ndryshimeve në ligjin Nr. 9870/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, si dhe mungesës së bashkëveprimit me Ministrinë e Brendshme si institucion i përfshirë, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht**.

5- Gjetje nga auditimi: Baza ligjore dhe rregullatore aktualisht në fuqi nuk parashikon ndërhyrjen e shërbimit psikologjik në fazën e hartimit të raportit të vlerësimit të riskut. VKM – ja për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, dy udhëzimet e përbashkëta të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë, si dhe Protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor përmes MKR – së, nuk parashikojnë ndërhyrjen e psikologut në fazën e hartimit të raportit të vlerësimit të riskut.

5.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për ndryshimet e nevojshme në bazën ligjore rregullatore për përfshirjen e vlerësimit psikologjik gjatë fazës së vlerësimit të riskut për viktimat e dhunës në familje.

Brenda datës 31.12.2024

¹ Udhëzimi i Përbashkët nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”, Kreu II, pika 11.

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 06.01.2025 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Rekomandimi është ende në proces në kuadër të analizës për hartimin e legjislacionit.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, në vijim të masave për hartimin e legjislacionit, Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Nr. 39, datë 24.01.2024, “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit Teknik ndërinstitutional të punës për hartimin e ndryshimeve në ligjin Nr. 9870/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, si dhe mungesës së bashkëveprimit me Ministrinë e Brendshme si institucion i përfshirë, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht**.

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Pyetje e auditimit: A kanë ndikuar pozitivisht masat parandaluese të marra për dhunën ndaj grave në marrëdhëniet familjare?

2- Gjetje nga auditimi: Bazuar në treguesit e evidentuar konstatohet se në përmbushje të trajtimit sa më të efektshëm të çështjeve të dhunës në familje e dhunës ndaj grave në nivel vendor (bashkitë/njësitë e vetëqeverisjes vendore), konstatohet se vetëm 5 Bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan dhe Korçë), kanë hartuar Planet e Veprimit për Barazinë Gjinore në përputhje me Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave, ndërsa bashkitë e tjera nuk kanë një Plan veprimi vendor për çdo bashki dhe shtrirjen e tyre në plan veprimi për ato Njësi Administrative që janë me risk të lartë në mungesën e barazisë gjinore të ndikuar nga faktorë të ndryshëm territorial (Njësi administrative/Qark). Mungesa e këtyre Planeve veprimi vendore nuk përkon me detyrimin që kanë këto njësi vendore në zbatim të Strategjisë Kombëtare “Për Barazinë Gjinore dhe të Planit të Veprimit 2016-2020”, miratuar me VKM nr. 73, datë 20.10.2016 dhe Objektivin 3.1 “Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje” dhe Objektivi 4.4 “Ndërgjegjësimi i shoqërisë për pranimin e barazisë gjinore si kusht i domosdoshëm për zhvillimin e vendit”; dhe kërkesat e Strategjisë Kombëtare “Për Barazinë Gjinore dhe të Planit të Veprimit 2021-2030” miratuar me VKM nr. 400, datë 30.06.2021.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme të marrin masa, për të kërkuar nga të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (Bashki/Qark dhe Njësi Administrative) përgatitjen dhe miratimin në Këshillin Bashkiak/Qarkut të Planit të Veprimit vendor për barazinë gjinore dhe dhunën ndaj grave, duke përcaktuar sa më qartë hapat, strukturat e përfshira, fushat e bashkëpunimit me institucione shtetërore dhe organizata joqeveritare, institucionet vendore të arsimit etj., të përfshira në zinxhirin e ngritur nga momenti i referimit deri në zgjidhjen e problemit paraqitur si dhe të evidentohet qartë veprimtaria ndërgjegjësuere e parandaluese në këtë drejtim.

Brenda datës 30.06.2024

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 06.01.2025 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Në zbatim të këtij rekomandimi MSHMS në bashkëpunim me U.. W... kanë mbështetur procesin për nënshkrimin e Kartës Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore. Ky proces do të vazhdojë të shtrihet edhe në ato bashki që nuk e kanë pas nënshkruar më parë dhe është parashikuar të zgjasë për 3 vjet.

Po në kuadër të zbatimit të rekomandimit MSHMS, ka realizuar një takim kombëtar (7 mars 2024), me fokus përmirësimin e punës së MKR-ve, ku morën pjesë dhe shkëmbyen përvojat dhe sfidat, kryetarë të bashkive të ndryshme të vendit si dhe 61 koordinatorët vendorë kundër dhunës në familje.

MSHMS në bashkëpunim me organizatat e OKB-së në Shqipëri, institucionet qendrore dhe ato të vetëqeverisjes vendore, si dhe OJF-të, nga data 25 Nëntor – 10 Dhjetor (por dhe më tej), koordinoi Fushatën Kombëtare të 16 Ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave e vajzave me sloganin: “Asnjë Justifikim: Bashkë kundër dhunës ndaj grave e vajzave!”

Një numër i madh aktiviteteve u zhvilluan në të gjithë territorin e Shqipërisë në kuadër të Fushatës Kombëtare, të cilat kishin si qëllim jo vetëm sensibilizimin e shoqërisë por edhe fuqizimin e të gjitha MKR-ve me qëllim rritjen e eficiencës së mekanizmave të referimit për mbrojtjen e viktimave të dhunës, fuqizimin e bashkëpunimit, rritjen e ndërgjegjësisë shoqërore, etj.

Bashkëlidhur Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Nr. 39, datë 24.01.2024, “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit Teknik ndërinstitutional të punës për hartimin e ndryshimeve në ligjin Nr. 9870/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, duke vlerësuar masat e marra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por dhe nevojës për përgatitjen dhe miratimin në Këshillin Bashkiak/Qark të Planit të Veprimit vendor për barazinë gjinore dhe dhunën ndaj grave rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.**

3- Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni dhe informacioni i paraqitur u konstatua se, mungon një plan buxhetimi në tërësi dhe në mënyrë analitike lidhur me fushatat sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere për parandalimin e dhunës ndaj grave e vajzave, në institucionet qendrore (MSHMS, MAS, MB e MD) dhe ato vendore ku përmendim drejtoritë rajonale në qarqe dhe zyrat e shërbimit social në bashki. Evidentohet, mos konsolidim i buxheteve për barazinë gjinore në këto institucione dhe mungesë bashkëpunimi me shoqatat e organizatat e shoqërisë civile, në funksion të financimit dhe ndjekjes së përdorimit të fondeve sipas kërkesave të ligjit për buxhetin dhe akteve nënligjore në funksion të tij. Ka munguar financimi për organizatat e shoqërisë civile, si një faktor me ndikim të rëndësishëm, në kryerjen e aktiviteteve sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere për parandalimin e dhunës në familje. Nuk është siguruar një shpërndarje e drejtë e aktiviteteve në zonat e vendit sipas hartës së DHF e DHNGV, pasi shoqatat janë më të përqendruara në Tiranë, Durrës e qytete të tjera të mëdha, çka ka lënë jashtë vëmendjes qytetet e vogla dhe zonat e largëta rurale.

3.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në rolin e autoritetit kryesor përgjegjës, të kërkojë nga institucionet e tjera që ngarkohen me ligj, pjesë të zinxhirit të trajtimit të viktimave të dhunës ndaj grave në marrëdhëniet familjare si dhe detyrimeve ligjore për marrjen e masave parandaluese, të marrin masa për të rritur buxhetet për barazinë gjinore sa i përket parandalimit dhe të bëjnë programimin dhe zbatimin analitik të fondeve.

Në vijimësi

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 06.01.2025 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Në kuadër të përgatitjes së projektbuxhetit afatmesëm, i cili hartohet çdo vit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka reflektuar sugjerimet e sjella nga Ministria e Financave lidhur me shtimin e treguesve të performancës me bazë gjinore. Në programin buxhetor “Përkujdesi Social, treguesit e performancës janë me bazë gjinore”.

Lidhur me produktin e Fondit Social, të Programit Buxhetor “Përkujdesi Social” për vitin 2024 janë financuar:

-6 Shërbime Emergjence multifunksionale për viktimat e dhunës (Bashkia Berat, Maliq, Kukës, Gjirokastrë, Durrës, Dimal, Memaliaj) me rreth 1,555 përfitues.

- 2 shërbime emergjence multifunksionale për viktimat e dhunës në bashkitë Dimal dhe Memaliaj-financim për herë të parë

Në shërbimin e Bashkisë Dimal është realizuar plotësimi i strukturës me staf mbështetës (1 NJMF dhe 1 punonjës social me kohë të pjesshme për dhomat e emergjencës). Gjithashtu, në Bashkinë Memaliaj funksionon Qendra për Shërbime Mbrojtëse, Fuqizuese dhe Emergjente për Fëmijët dhe Familjet duke ofruar shërbime mbështetëse psiko-sociale për fëmijët dhe rastet emergjente të dhunës.

-3 Strehëza për Viktimat e Dhunës dhe Trafikimit (Qarku Tirane, Elbasan, Vlore) me rreth 1,165 përfitues.

-1 Linjë Këshillimi Kombëtare në Qarkun e Tiranës me rreth 1,358 përfitues nga të cilët 540 telefonata këshillimi dhe 880 raste të trajtuara dhe referuara.

-1 Shërbim Rezidencial Ditor për gratë dhe vajzat në situatë vulnerabël në Qarkun Lezhë me rreth 65 përfitues.

Totali: 11 Shërbime për Viktimat e Dhunës.

4,143 përfitues/e viktimat të dhunës.

-Financimi për vitin 2024: 79,471,183 Lekë, krahasuar me 51,829,741 lekë

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, duke vlerësuar masat e marra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por dhe afatit në vijimësi për zbatimin e rekomandimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi**.

3.2 Rekomandimi: Ministra e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me institucionet e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, të marrin masa të organizojnë trajnime të mirë përcaktuara për çështjet e dhunës me bazë gjinore për punonjës të shëndetit, punonjës sociale, juristë dhe profesionistë të tjerë, të cilët ofrojnë shërbime pranë çdo njësie të vetëqeverisjes vendore, stafit mjekësor, dhe OJF-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale.

Në vijimësi

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 06.01.2025 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

- Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të nëpunësve gjinore dhe koordinatorëve vendorë të dhunës në marrëdhëniet familjare (KV), rikujtojmë se KV janë të vendosur në 61 Bashki të vendit. MSHMS, në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtare, ka mundur ofrimin dhe lehtësimin e trajnimeve me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre.

- Në datën 29 Prill 2024, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale organizoi workshop-in me temë: “Ndarja e Përvojave në Mbështetje të të Mbijetuarave/Mbijetuarve të Dhunës Seksuale në Shqipëri”. Në aktivitet ishin pjesëmarrës përfaqësues të tre qendrave të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale, si dhe mekanizmat përkatës të referimit duke ofruar një mundësi për të prezantuar dy modelet e shërbimit si dhe për të ndarë praktikat më të mira dhe sfidat e hasura në adresimin e nevojave të të mbijetuarave/mbijetuarve.
- Në datën 27 – 28 Qershor 2024 u zhvillua takimi i Rrjetit Kombëtar të Koordinatorëve vendorë kundër dhunës në marrëdhëniet familjare. Qëllimi i takimit ishte fuqizimi i rolit të Koordinatorëve vendorë kundër dhunës, të forcojë më tej kapacitetet e tyre në trajtimin e rasteve viktime të dhunës si dhe të lehtësojë shkëmbimin e eksperiencave, ndarjen e praktikave të mira dhe sfidave të hasura duke promovuar një qasje të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse në mbështetje të viktimave dhe në parandalimin e dhunës.
- Në korrik 2024, u organizua takimi dy ditor me rrjetin e koordinatorëve vendorë mbi referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare. Takimet kontribuan në forcimin e kapaciteteve të koordinatorëve vendorë në trajtimin e viktimave të prekur nga dhuna, për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira ndërmjet pjesëmarrësve si dhe kanë nxitur adresimin e sfidave dhe përvojave të tyre gjatë punës.
- Në 11 shtator 2024, u organizua trajnimi me nëpunës gjinor të ministrive të linjës dhe institucioneve të varësisë mbi Planin e Veprimit Nr. 2 për Agjendën Gruaja, Paqja dhe Siguria.
- Në 18 shtator, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, mundësoi trajnimin për dy specialistët e sapo emëruar në Sektorin e Barazisë Gjinore, të dedikuar në përdorimin e sistemit REVALB.
- Trajnimi u ofrua nga dy ekspertë të jashtëm të cilët janë të specializuar në sistemin REVALB dhe kanë mundur trajnime edhe për Koordinatorët Vendorë si pjesë të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit.
- Dy specialistët përveç se u njohën me platformën dhe rolin e saj në mbledhjen dhe menaxhimin e rasteve nga i gjithë aparati i MKR-së, qartësuan edhe rolin dhe përgjegjësitë e tyre si monitorues të sistemit REVALB dhe punës së MKR-së në raport me sistemin REVALB. Në datën 20 shtator, ekspertet ndanë përmes postës elektronike kredencialet për të aksesuar sistemin e REVALB, si monitorues, për dy specialistët e Drejtorisë së Barazisë Gjinore.
- Në datat 7 dhe 8 nëntor, u zhvillua takimi kombëtar me koordinatorët vendorë (KV) të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) nga të 61 Bashkitë e vendit, me temë dhe nën sloganin: "Asnjë Justifikim! Bashkë Kundër Dhunës Ndaj Grave dhe Vajzave". Takimi kombëtar kishte si qëllim fuqizimin dhe rritjen e kapaciteteve për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.
- Në datën 14 dhjetor, MSHMS u përfaqësua në aktivitetin përmbyllës të programit Bootcamp “Ndryshimi fillon me ty”, pjesë e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund dhunës ndaj grave“, i cili bëri bashkë të rinj të apasionuar pas teknologjisë duke sjellë ide konkrete për të luftuar dhunën me bazë gjinore. Në këtë eveniment, MSHMS shprehu përkushtimin dhe angazhimin institucional në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe përparimin e barazisë gjinore përmes edukimit dhe ndërgjegjësimin, veçanërisht tek të rinj dhe të rejtat.
- Në datën 17 dhjetor, MSHMS u përfaqësua tek aktiviteti i organizuar nga Rrjeti i Organizatave “Z....” dhe Zyra e U....-së në Shqipëri, të cilët për të pestin vit radhazi mbajtën Forumin "Djem dhe Burra që Frymëzojnë – Edicioni i 5-të", një ngjarje kyçe kushtuar avancimit të barazisë gjinore, luftës ndaj dhunës me bazë gjinore dhe transformimit të maskulinitetit patriarkal.
- Bashkëlidhur: - Workshop për ndarjen e nevojave në mbështetje të të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës seksuale në Shqipëri 29. Prill 2024.

- Trajnim me pjesëmarrjen e koordinatorëve vendorë në bashki për përdorimin e sistemit elektronik REVALB Mars 2024
- Trajnim me pjesëmarrjen e koordinatorëve vendorë në bashki për përdorimin e sistemit elektronik REVALB Prill 2024
- Takim i rrjetit të Koordinatorëve Vendorë Kundër Dhunës në Familje Nëntor 2023, agjenda dhe lista e pjesëmarrjes.
- Takim i rrjetit të Koordinatorëve Vendorë Kundër Dhunës në Familje Qershor 2024 dhe agjenda.
- Trajnim i Specialistëve të Sektorit të Barazisë Gjinore për monitorimin e sistemit elektronik REVALB shtator 2024
- Trajnim dy (2) ditore me pjesëmarrjen e Koordinatorëve Vendorë Kundër Dhunës në Familje Nëntor 2024

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, duke vlerësuar masat e marra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por dhe afatit në vijimësi për zbatimin e rekomandimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi**.

4- Gjetje nga auditimi: Nga strukturat e policisë së shtetit nuk është punuar vazhdimisht me bazë risku. Nuk ka programe të veçanta të miratuara për fushata parandaluese apo aktivitete të ndryshme ndërgjegjësimi në komunitet. Mungojnë trajnimet e dedikuara për punonjësit që punojnë në zonat me risk të lartë për krime dhune ndaj grave e vajzave dhe dhunës në familje, çka ndikon si në aspektin e mos deklarimit të rasteve nga viktimat, por edhe në mos ndjekjen e problemeve për mbrojtjen e viktimave të dhunës si dhe vënien përpara përgjegjësisë ligjore të dhunuesit.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nëpërmjet strukturave përkatëse të hartojë programe të veçanta dhe të marrë masa për përcaktimin e zonave apo territoreve që kanë risk të lartë krimi të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave e vajzave, si dhe të organizojë përshpejtimin e programeve trajnuese mbi zbatimin e procedurave të miratuara të vlerësimit të riskut për punonjësit e policisë nga vetë institucionet shqiptare, krahas mbështetjes që ofrohet nga organizatat ndërkombëtare.

Në vijimësi

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me nr. 11110 prot., datë 14.01.2025 regjistruar në KLSH me nr. 1481/2 prot., datë 14.01.2025 ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit mori në shqyrtim me kujdes rekomandimin Tuaj dhe në vijimësi analizon situatën në lidhje me dhunën në marrëdhëniet familjare në vend.

Është hartuar dhe dërguar DVP-ve Plan – Veprimi Nr. 383, datë 22.01.2024 “Për masat që duhet të merren nga strukturat e policisë së shtetit për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, për vitin 2024”.

Është analizuar situata dhe dërguar DVP-ve Tërheqje-vëmendje Nr.2734/1, datë 02.04.2024 “Mbi marrjen e masave për parandalimin, evidentimin dhe informimin për rastet e ngjarjeve të rënda të dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Është dërguar strukturave vendore Letër-porosi Nr.7914, datë 22.08.2024 “Mbi rritjen e bashkëpunimit në trajtimin e rasteve të dhunës në familje ndërmjet strukturave të policisë dhe njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Lidhur me rekomandimin për marrjen e masave për organizimin, përshejtimin e programeve trajnuese ju informojmë se në varësi të DPPSh është ngritur Drejtoria e Planifikimit dhe Administrimit të Trajnimit Policor. Kjo drejtori, çdo vit, harton dhe ndjek Programin Mësimor për Trajnimin e Detyrueshëm në Shërbim ku është e përfshirë edhe tema e dhunës në familje (bashkëlidhur Programi Mësimor miratuar me Urdhër të DPPSH nr.1794, datë 22.12.2023).

Theksojmë se, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka planifikuar dhe zbatuar në vijimësi masa prioritare për aftësimin e punonjësve të saj, trajtimin me përgjegjësi të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, duke bashkëpunuar ngushtësisht edhe me institucione të tjera, si pjesë e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit dhe në zbatim të projekteve/programeve të miratuara. Pavarësisht se disa trajnime zhvillohen në kuadër apo në bashkëpunim me këto programe, sqarojmë se vlerësimi i nevojave, planifikimi dhe monitorimi i tyre bëhet në bashkëpunim me institucionin. Gjithashtu, në kuadër të këtyre programeve, shumë trajnime bëhen me të gjithë zinxhirin e institucioneve duke identifikuar edhe problematikat.

Gjatë vitit 2024 nga Sektori kundër Dhunës në Familje dhe Mbrojtjes së të Miturve, në Drejtorinë për Krimet në Volum, në Departamentin për Sigurinë Publike, në bashkëpunim me U.....² janë planifikuar dhe zhvilluar trajnime në komisaritet e policisë së DVP Korçë, Berat, Fier, Gjirokastrë, si dhe komisaritet e policisë Has, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë, me temë “Për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje”. Në këto trajnime morën pjesë edhe Koordinatorët Vendorë të bashkive/njësive të vetëqeverisjes vendore. Në këto trajnime, kanë marrë pjesë 214 specialistë/ndihmës specialistë/ për krimet dhe ndihmës/specialist SPZ. Punonjësit e policisë janë pajisur edhe me Udhëzuesit e xhepit për Punonjësit e Policisë në Trajtimin e Rasteve të Dhunës. (Bashkëlidhur Urdhrat nr. 287, datë 14.10.2024; nr.296, datë 21.10.2024; nr. 307, datë 30.10.2024; nr.330, datë 19.11.2024; nr. 331, datë 19.11.2024 të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për zhvillimin e trajnimeve me temë për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje”).

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, duke vlerësuar masat institucionale të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, dhe afatin në vijimësi për implementimin e tij, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi**.

4.2 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe bashkitë në vend, të kryejnë fushata ndërgjegjësimi me programe për rritjen e kapaciteteve të strukturave policore e atyre vendore veçanërisht në zonat e largëta të cilat kanë mungesë të shërbimeve lokale, për të qenë sa më afër viktimave të dhunës, mbështetjen e menjëhershme psiko - sociale e ligjore, si dhe shmangien e veprimeve që mund të sjellin stigmatizimin e denoncueseve të dhunës.

Në vijimësi

² Në kuadër të Programit të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund dhunës ndaj grave- faza e dytë”.

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me nr. 11110 prot., datë 14.01.2025 regjistruar në KLSH me nr. 1481/2 prot., datë 14.01.2025 ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Për vitin 2024, në kuadër të fushatës së përvitshme “16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore” (25 Nëntor – 10 Dhjetor), Policia e Shtetit, si një ndër institucionet kryesore përgjegjëse dhe pjesë e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, i është bashkuar aktiviteteve të organizuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe organizata të ndryshme që veprojnë në këtë fushë, për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

U hartua Urdhri i DPPSH Nr.1548, datë 20.11.2024 “Për marrjen e masave në kuadër të fushatës sensibilizuese kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, nga data 25 Nëntor deri më 10 Dhjetor 2024” dhe bazuar në këtë urdhër drejtoritë vendore të policisë hartuan programet e aktiviteteve sensibilizuese.

Janë zhvilluar takime sensibilizuese, në bashkëpunim me koordinаторët vendore të dhunës në bashki në shkollat e mesme, me target-grupe të ndryshme, në të cilat u është dhënë informacion mbi dhunën në familje, kuadrin ligjor për masat ndaj dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, strukturat përgjegjëse, rolin e mekanizmit referues të dhunës, informacion për shërbimet policore, roli i policisë në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe rolin e organizatave jo fitimprurëse, duke e trajtuar në formën e diskutimeve të hapura.

Punonjësit e policisë që morën pjesë në takime/aktivitete sensibilizuese synuan të japin mesazhet:

- dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje është krim dhe e dënueshme;*
- rritin njohuritë për rolin e policisë në këtë proces;*
- informacione të sakta për publikun, se ku mund të drejtohen dhe çfarë duhet të bëjnë në rastet e dhunës.*

Është marrë pjesë në disa emisione në televizione lokale dhe kombëtare, si dhe janë dhënë mesazhe mbështetjeje dhe janë ndarë praktika të mira të punës, në rrjetet sociale të Policisë së Shtetit. Janë shpërndarë për drejtoritë vendore të policisë materiale sensibilizuese (banera, postera, byzylykë, fletëpalosje dhe stilolapsa) të prodhuara në bashkëpunim me U... dhe programin Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri (SCPA), me mesazhet: Të ndalim dhunën ndaj grave Tani”, “Dhuna në familje nuk është thjesht çështje e familjes”, “Bashkë kundër dhunës” etj. si dhe vendosjen e pankartave në vende të dukshme në komisaritet e policisë “Raporto dhunën ndaj grave”, “Telefono Policinë e Shtetit 112 dhe 129”.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, duke vlerësuar masat institucionale të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, dhe afatin në vijimësi për implementimin e tij, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

1.2.1 Pyetje e auditimit: Si ka funksionuar përgjigjja dhe menaxhimi i rasteve të dhunës ndaj grave në marrëdhëniet familjare nga institucionet e përfshira?

1- Gjetje nga auditimi: Në rolin e vet si institucion politik bërës, vëzhgues e monitorues (nëpërmjet institucioneve përkatëse të varësisë) të mekanizmit të ngritur për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje me të gjitha nuancat institucionale e shoqërore që mbartin këto, vërehet se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk arrin të kryejë analiza të thella dhe domethënëse për situatën aktuale të këtij mekanizmi dhe shërbimeve që janë mundësuar në nivel

kombëtar dhe lokal për përballimin e kësaj patologjie sociale. Konkretisht, sistemi REVALB nuk është fuqizuar dhe nuk është siguruar lidhja me sisteme të tjera relevante të mbledhjes së të dhënave, si SSHKSH (Sistemi i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror). Gjithashtu, në vendin tonë ende nuk ka asnjë shërbim të ngritur për strehimin/rehabilitimin e dhunuesit në momentin kur urdhërohet largimi i menjëhershëm nga banesa.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të kryejë një vlerësim të thelluar të Mekanizmit duke i kushtuar një rëndësi të veçantë angazhimit real të anëtarëve të mekanizmit, nevojave për shërbime e financime sipas karakteristikave të qarqeve e bashkive, me qëllim identifikimin e saktë të ndërhyrjeve të nevojshme për fuqizimin e mekanizmit të tij.

Brenda datës 31.12.2024

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 06.01.2025 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

MSHMS në bashkëpunim me U..... kanë kryer një vlerësim të MKR-ve duke marrë në analizë veprimtarinë e tyre, Gjetjet paraprake të këtij vlerësimi u prezantuan në Takimin Kombëtar që MSHMS organizoi në datën 7 mars 2024 me përfaqësues nga të 61 MKR-të e vendit.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, duke vlerësuar masat e marra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për zbatimin e rekomandimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

3- Gjetje nga auditimi: Strukturat vendore të policisë së shtetit nuk kanë dhoma të dedikuara për marrjen e denoncimeve në rastet e dhunës në familje. Raste e dhunës në familje trajtohen njësoj si denoncimet e tjera pranë strukturave vendore të policisë. Në DVP Gjirokastër (Komisariati Gjirokastër) punonjësit e policisë, në mungesë të një ambienti për të marrë denoncimet, shpesh herë trajtojnë rastet e dhunës në familje në zyrat e specialistëve përkatës e jo në ambiente të dedikuara.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë masa për të siguruar kushtet infrastrukturore të përshtatshme për trajtimin e rasteve të dhunës në familje me qëllim trajtimin me respekt e dinjitet dhe ruajtjen e fshehtësisë dhe konfidencialitetin.

Brenda datës 30.06.2024

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me nr. 11110 prot., datë 14.01.2025 regjistruar në KLSH me nr. 1481/2 prot., datë 14.01.2025 ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Aktualisht, Policia e Shtetit ka 15 Njësi Intervistimi për të Mitur në strukturat vendore të policisë, të cilat përdoren edhe në rastet e viktimave të dhunës në familje, krimeve seksuale, VT/VMT.

Në bashkëpunim me UNICEF - Shqipëri, në kuadër të projekteve "Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria" dhe Projektit "Qasjes së Miturve në Drejtësi", të mbështetura nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe Ministria norvegjeze janë ngritur shtatë ambiente miqësore për intervistimin e të miturve, në strukturat vendore të policisë, e konkretisht:

- Drejtorinë Vendore të Policisë Berat,

- Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastrë,
- Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër,
- Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës,
- Drejtorinë Vendore të Policisë Fier,
- Komisariatin e Policisë Sarandë,
- Komisariatin e Policisë Korçë,

Në kuadër të programit të Programit (Shqiptaro-Suedez) “Forcimi e kapaciteteve të agjencive ligj zbatuese dhe gjykatave shqiptare për të përmbushur standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për drejtësinë për të miturit - një qasje gjithëpërfshirëse e zinxhirit të drejtësisë”, është realizuar krijimi/përshtatja e katër ambienteve miqësore për intervistimin e të miturve, në strukturat policore të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Shkodër e konkretisht:

- Komisariatin e Policisë Nr.3, -Tiranë.
- Drejtorinë Vendore të Policisë- Durrës.
- Drejtorinë Vendore të Policisë – Shkodër.
- Drejtorinë Vendore të Policisë – Vlorë.

Në bashkëpunim me organizatat A....dhe W... V.... është bërë e mundur përshtatja e katër ambienteve miqësore për intervistimin e të miturve, në strukturat policore të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Lezhë, e konkretisht:

- Komisariatin e Policisë Nr.5, Tiranë.
- Komisariatin e Policisë Nr.6, Tiranë.
- Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë.

Në kuadër të Programit "Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri" (SCPA)", është përfunduar përshtatja e një ambienti miqësor për intervistimin e të miturve në strukturat policore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.

Gjithashtu, Policia e Shtetit është duke bashkëpunuar me organizatën “O... H...N...OUR”, me seli në USA dhe “F.. F..t (G...) Albania” të cilat kanë shprehur dëshirën për financimin dhe bërjen e rikonstruksionit të dhomave të intervistimit, për 12 DVP-të dhe disa komisariate, të cilat ndodhen larg nga DVP-të dhe pajisjen e këtyre dhomave me mjete logjistike. (bashkëlidhur Memo nr.3901, datë 31.10.2024 e Departamentit të Policisë Kriminale).

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, duke vlerësuar masat institucionale të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

4-Gjetje nga auditimi: Në strukturat vendore të Policisë së Shtetit ndihmës specialistët/specialistët e krimeve që kryejnë menaxhimin fillestar të rasteve të dhunës në familje nuk janë të dedikuar vetëm për këtë funksion. Policia e Shtetit, edhe pse i ka dhënë përparësi krijimit të këtyre funksioneve, ende nuk i jep rëndësinë e duhur këtij funksioni, siç edhe ka ndodhur në vende të tjera fqinje në rajonin tonë, ku kjo figurë është e dedikuar.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të ngrejë grup pune për të vlerësuar krijimin e funksionit të dedikuar specialist/ndihmës specialist për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

Brenda datës 30.06.2024

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me nr. 11110 prot., datë 14.01.2025 regjistruar në KLSH me nr. 1481/2 prot., datë 14.01.2025 ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Ju bëjmë me dije se, me riorganizimin dhe ndryshimet strukturore të qershorit të vitit 2023, planifikimi, menaxhimi dhe drejtimi i shërbimeve policore bëhet mbi bazën e “Zonës Policore”.

Me ri-organizimin dhe ndryshimet strukturore:

- Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Sektori Kundër Dhunës në Familje dhe Mbrojtjes së të Miturve, me përbërje 1(një) Shef Sektori dhe 2(dy), ndryshoi varësi dhe kaloi në Departamentin për Sigurinë Publike, në Drejtorinë për Krimet në Volum.
- Në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në Sektorin për Krimet në Volum, është Seksioni për parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjes së të miturve, me përbërje 1(një) Shef Sektori dhe 2(dy).
- Në 11 Drejtoritë Vendore të Policisë, në Sektorin për Krimet në Volum, në Seksionin për Krimet ka 1 funksion organik “Specialist për dhunën në familje”.
- Në Komisariatet e Policisë, në Seksionin për Hetimin e Krimeve në Volum, ka specialistë/ndihmës specialistë për krimet (ata edhe për dhunën në familje), sipas zonave policore.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, duke vlerësuar masat institucionale të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, por edhe nevojës për një vlerësim specifik në nivel kombëtar të këtij funksioni konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.**

6- Gjetje nga auditimi: Në 37 bashki të vendit koordinatori vendor i dhunës nuk është i dedikuar për të mbuluar vetëm rastet e dhunës në familje. Në Bashkinë Gjirokastrë, KVDH për periudhën nëntor 2021 – e në vijim është alternuar nga pozicioni i KVDH në pozicionin e punonjësit administrativ të Qendrës Emergjente të Viktimave të Dhunës në Familje. Aktualisht KVDH ende rezulton si punonjës administrativ i kësaj qendre, por që mbulon edhe detyrën e KVDH – së në Bashkinë Gjirokastrë. Po kështu, në Bashkinë Kukës, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka vetëm një specialiste Punonjëse Sociale, e cila kryen edhe rolin e Koordinatorit Vendor për rastet e grave të dhunuara. Kjo bashki nuk ka aktualisht në strukturë një pozicion specifik Koordinator Vendor. Gjithashtu, rezulton se vitin e fundit në rang republike janë zëvendësuar 18 KVDH, të cilët duhet të ri - trajnohen për të kryer funksionet e tyre.

6.1 Rekomandimi: Bashkitë Gjirokastrë dhe Kukës të përfshijnë në strukturat e tyre Koordinatorin vendor të dhunës si funksion më vete, pa mbivendosje me funksione të tjera në fushën e barazisë gjinore.

Brenda datës 30.06.2024

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

-Bashkia Kukës me shkresën nr. 5550/1 prot., datë 14.01.2025 ka përcjellë shpjegimet përkatëse.

Në strukturën e vitit 2025 është përfshirë Koordinatorin vendor i dhunës si funksion më vete.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

-Bashkia Gjirokastrë me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 18.12.2024 ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Në përgjigje të rekomandimit nr. 6.1 fq.6, i cili lidhet me rolin e Koodinatorit/es Vendor/e, prej muajit janar të vitit respektiv, ky rol mbulohet prej punonjësës administrative të Agjencisë së Shërbimit Social dhe Shëndetësor, të cilës i janë deleguar të gjitha kompetencat dhe detyrat që lidhen me rolin e KV-së, si një detyrë funksionale e vetme pa detyra shtesë.

Referuar rekomandimit të dhënë, ky pozicion pune duhet të jetë pa mbivendosje me funksione të tjera. Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër duke vlerësuar masat e marra nga institucionet rekomandimi në tërësi konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.**

7- Gjetje nga auditimi: Komitetet Drejtuese të mekanizmit të koordinuar të referimit në nivel bashkie nuk mblidhen rregullisht për të ushtruar funksionet e tyre. Gjatë këtij auditimi ka rezultuar se, pavarësisht ngritjes së tyre në ato bashki ku është ngritur MKR, ky organ nuk është mbledhur rregullisht, çdo tre muaj ose në mbledhje të jashtëzakonshme sipas nevojave. Më konkretisht për periudhën 2020 – 2022, në bashkinë Durrës, KD është mbledhur në total 3 herë, ndërkohë që ka pasur takime më të shpeshta në nivel ETN – je, 6 herë në vitin 2020, 10 herë në vitin 2021 dhe 12 në vitin 2022. Ndërkohë, në Bashkitë Kukës dhe Gjirokastrë nuk ka gjurmë të mbledhjes dhe funksionimit të duhur të KD.

7.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të ngrejë një grup pune për të kryer një monitorim të mirëfilltë të funksionimit të MKR – së në Bashkitë Durrës, Kukës dhe Gjirokastrë, përfshirë këtu në veçanti veprimtarinë e Komitetit Drejtues dhe angazhimit të tij për mirëfunksionimin e mekanizmit.

Brenda datës 30.06.2024

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 06.01.2025 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Bashkitë Durrës, Kukës, Gjirokastrë janë pjesë e analizës së kryer për funksionimin e MKR-ve për të gjitha bashkitë e vendit.

Me Urdhër të Kryeministrit Nr. 205, datë 23.10.2024, Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është krijuar Drejtoria e Barazisë Gjinore, Tashmë, Drejtoria e Barazisë Gjinore ka në përbërje të saj dy sektorë, sektorin e Barazisë Gjinore dhe Sektori i Luftës ndaj Dhunës në Familje.

Me plotësimin me burime njerëzore të Sektorit të Luftës ndaj Dhunës në Familje, do të jetë ky sektor që do të monitorojë dhe vlerësojë aktivitetin e MKR-ve si detyrë funksionale.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, duke vlerësuar masat e marra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

1.2.2 Pyetje e auditimit: A ka funksionuar sistemi i raportimit, monitorimit të procesit?

1- Gjetje nga auditimi: Në strategjinë për Barazinë Gjinore 2021 - 2030 është vendosur si objektiv “Fuqizimi i sistemit REVALB dhe përdoruesve/përdoruesve të tij”. Nga auditimi u konstatua se, përdorimi i sistemit REVALB për evidentimin e monitorimin rasteve të të

mbijetuarave të dhunës në familje është dobësuar, ku në dy vitet e fundit ra nga 65% në 51% dhe 31% të numrit të bashkive gjithsej që identifikojnë në sistem rastet e dhunës në familje.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të hartojë plan veprimi me masa e afate konkrete për përdorimin e sistemit Regjistrimi i Dhunës në Familje (REVALB) nga të gjitha Bashkitë, si dhe përditësimin e hedhjes së të dhënave të prapambetura nga viti 2021 në sistem.

Brenda datës 31.12.2024

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 06.01.2025 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Është hartuar një plan pune për përdorimin e sistemit REVALB nga Koordinatorët Vendorë Kundër Dhunës në Familje. Planu u hartua bazuar në një vlerësim të nevojave dhe evidentim të njohurive që të gjithë KV kishin mbi sistemin. Trajnimet po realizohen me mbështetjen e ekspertëve të U...-së.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, duke vlerësuar masat e marra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por edhe nevojës për hedhjen e plotë të të dhënave në sistem, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi**.

2- Gjetje nga auditimi: Sistemi i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror (SSHKSH) duhet të përditësohet me të gjitha rastet e dhunës në familje. Nga auditimi dhe analiza e situatës u konstatua se, përdorimi i tij për trajtimin dhe monitorimin e rasteve të shërbimeve shoqërore për të mbijetuarat e dhunës në familje është në nivele shumë të ulëta mes 0.5 deri 1.8%. Ndërsa këto raste janë përditësuar në SSHKSH nga 8 - 18% e bashkive.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të hartojë plan veprimi me masa e afate konkrete për përdorimin e Sistemit të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror (SSHKSH) dhe monitorimin nëpërmjet tij të situatës së shërbimeve shoqërore për të mbijetuarat e dhunës në familje në vend.

Brenda datës 30.06.2024

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit (MSHMS)

Për këtë rekomandim është dhënë përgjigjja nga Shërbimi Social Shtetëror.

MSHMS këtë rekomandim në Programin e Punës 20 ditë ia ka deleguar Shërbimit Social Shtetëror. Sipas informacionit të përcjellë nga SHSSH, evidentohet mungesa e monitorimit mbi masën e përmbushjes së detyrimeve për popullimin e sistemit. Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit (SHSSH)

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 24.12.2024 Shërbimi Social Shtetëror ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

1.Në bazë të planit të veprimit të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, janë vendosur masat që do të merren për përdorimin e sistemit të shërbimit të kujdesit shoqëror.

2.Drejtoria e Shërbimeve Sociale në SHSSH ka hartuar me nr. 3507 prot, datë 07.05.2024 program trajnimi për të gjithë përdoruesit e sistemit të SHKSH-së. Subjekti i tajnimit janë 61 bashki të vendit, qendrat publike komunitare dhe rezidenciale, qendrat e emergjencës dhe drejtoritë rajonale të SHSSH-së.

3.Përsa i përket rekomandimit 2.1 Shërbimi Social Shtetëror ka marrë masat paraprake për funksionimin e sistemit të SHKSH duke dërguar shkresë nr. 9180 prot, datë 12.10.2023 drejtuar 61 bashkive të vendit dhe 12 drejtorive rajonale të SHSSH-së mbi vëmendjen për përdorimin e sistemit të SHKSH-së.

Bashkëngjitur gjeni programin e trajnimeve dhe shkresën drejtuar bashkive dhe DR të SHSSH.

Nga ana e Shërbimit Social Shtetëror janë marrë masa në drejtim të hartimit të planit të veprimit institucional për përdorimin e sistemit SSHKSH dhe dërgimit të shkresave bashkive të vendit për këtë qëllim, por duke vlerësuar dhe nevojën e monitorimit mbi masën e përmbushjes së detyrimeve për popullimin e sistemit. Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, rekomandimi në tërësi konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

3- Gjetje nga auditimi: Bashkitë dhe elementët përbërës të Mekanizmit të Koordinimit të Referimit janë të detyruara për monitorimin dhe raportimin e dhunës në familje. Nga auditimi u konstatua se në programet e monitorimit ose të auditimit në bashki kanë munguar aspekte të monitorimit të dhunës në familje. Gjithashtu kanë munguar, raportimi periodik tremujor, komunikim i përshtatshëm ndërinstitucional dhe aktualizimi i të dhënave në sistemin REVALB në Bashki.

3.1 Rekomandimi: Bashkitë Durrës Kukës dhe Gjirokastrë të hartojnë programe monitorimi ose auditimi mbi baze vjetore për monitorimin e aktivitetit të mekanizmit të koordinimit të referimit dhe të marrin masa për raportimin çdo tre muaj nga komiteti drejtues drejt MSHMS.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

-Bashkia Kukës me shkresën nr. 5550/1 prot., datë 14.01.2025 ka përcjellë shpjegimet përkatëse. Bashkia Kukës është duke punuar dhe shumë shpejtë do ta miratojë Programin Vjetor për vitin 2025, për monitorimin e aktiviteteve të mekanizmit të koordinimit të referimit dhe do jetë korrekte duke raportuar çdo tre muaj pranë MSHMS.

Bazuar në angazhimin institucional të marrë nga Bashkia Kukës, rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

-Bashkia Gjirokastrë me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 18.12.2024 ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Në përgjigje të rekomandimit nr 3.1 fq.7, Bashkia Gjirokastrë është ende në fazë hartimi të programeve të monitorimit dhe auditimit të punës së MKR, me qëllim realizimin e monitorimit cilësor i cili do mundësojë përmirësimin dhe rritjen e eficiencës në ofrimin e shërbimit dhe angazhimin, për secilin institucion pjesë e MKR.

Bazuar në angazhimin institucional të marrë nga Bashkia Gjirokastrë, rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.


-Bashkia Durrës me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 27.12.2024 ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Bashkia Durrës e mbështetur nga Programi "Fuqizojmë Komunitetin (ICR)" i U.... Shqipëri me mbështetjen financiare të U...., është angazhua gjatë vitit 2024 në ngritjen dhe funksionimin e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, në fuqizimin e mekanizmave të ETN dhe GTN një detyrim që rrjedh sa nga legjislacioni kombëtar, aq edhe nga nevoja për ti shërbyer cilësisht komuniteteve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje. Në kuadër të Programi "Fuqizojmë Komunitetin (ICR) nga P... janë kontraktuar dy ekspert konsulent Znj. E. B., e cila na ka mbështetur për të modeluar Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të rasteve dhe Znj. M. A. ka mbështetur punën tonë në mirë funksionimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në familje. Lidhur me këtë punë të bërë ju bashkëngjis analizën e nevojave, kalendarin e punës, në të cilin janë planifikuar trajnime dhe mentorime si dhe përfshirjen në trajnim edhe të sektorit të Planifikim Monitorimit të Drejtorisë së Shërbimit Social.

Ngritja e këtyre Njësive i mundëson Bashkisë për të identifikuar më mirë individët dhe familjet që kanë nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje, si dhe rrit reagimin e saj ndaj adresimit të këtyre nevojave duke sjellë ndikim të drejtpërdrejtë jo vetëm tek individët e mbrojtur/mbështetur, por edhe komuniteti lokal në tërësi. Funksionimi efektiv i vazhdueshëm i tyre do të sjellë ndikim social (përmirëson cilësinë e jetës së grupeve vulnerabël), ekonomik (nga fuqizimi ekonomik i individëve familjeve) dhe politik (rritje e mbështetjes publike) për Bashkinë Durrës. Punonjësit Social të Njësive të Vlerësimit të Nevojave janë një strukturë shumë e rëndësishme për monitorimin e vendimeve të gjykatës për urdhrat e të mbrojtjes.

Zhvillimet e kësaj periudhe kanë qenë të rëndësishme për të përmbushur objektivin e ngritjes dhe funksionimit të NJVNR.,

Arritjet e disa objektivave kanë kontribuar në përmbushjen e pesë objektivave kyç:



1. Identifikimi i kapaciteteve dhe nevojave: a) **Vlerësimi i Nevojave**³ - Analiza vlerësoi burimet njerëzore, procedurat e punës, bashkëpunimin ndër sektorial, kapacitetet dhe buxhetin. Asnjë njësi e ngritur para janarit 2024. B) **Plane Veprimi** - shërbeu si një udhërrëfyes për ngritjen e NJVNR;

2. Ngritja e NJVNR: a) **Takim me vendimmarrësit lokalë** për të diskutuar ngritjen e NJVNR- Procesi i vendimmarrjes përfshiu Drejtorinë e Shërbimit Social, Qendrën "Fuqizojmë

Komunitetin " Durrës dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në këtë Bashki. Kjo qasje përfshirëse siguroi përfshirjen e të gjithë aktorëve në ngritjen dhe funksionimin e NJVNR; b) **Vendimmarrja:** Drejtoria e Shërbimit Social formalizoi ngritjen e 7 NJVNR që mbulojnë këto territore:

Tabela 1: Përbërja e NJVNR

NJVNR	PERBERJA			SHENIM
	Administrator shoqëror	Punonjës Social	Punonjës Mbrojtjes Fëmijës i së	
Rajoni 1-2-3 Durrës	3	1	1	Punonjësja sociale staf i Qendrës Fuqizojmë Komunitetin; PMF staf i Drejtorisë së Shërbimit Social
Rajoni 4 Durrës	1	1	1	PMF staf i Drejtorisë së Shërbimit Social
Rajoni 5 Durrës	1	1	1	Punonjësja sociale staf i Qendrës Komunitare; PMF staf i Drejtorisë së Shërbimit Social
Rajoni 6 Durrës	1	1	1	Punonjësja sociale staf i Qendrës Komunitare; PMF staf i Drejtorisë së Shërbimit Social
Sukth	1	1	1	
Rrashbull	1	1	1	Punonjësja sociale staf i Qendrës Komunitare
Katund i Ri	1	1	1	
TOTALI	9	7	7	23

c) Secili nga 23 pozicionet e punës pjesë e 7 NJVNR (administrator social, punonjës social dhe punonjës për mbrojtjen e fëmijëve) tashmë ka detyra, përgjegjësi dhe varësi të detajuara, të cilat janë të detyrueshme për zbatim.

Përgjatë periudhës shkurt-qershor që janë zhvilluar trajnimet dhe mentorimet, në detyrë në NJVNR Forcimi dhe zhvillimi i mekanizmave dhe partneriteteve ndër sektoriale si dhe rishikimi i marrëveshjeve të mekanizmave ndër sektoriale ai kundër dhunës në familje.

Ne vijim të mbështetjes në kuadër Programit "Fuqizojmë Komunitetin (ICR)" prioritetet i punës edhe për vitin 2025 do të përfshijnë:

1. Konsolidim e kapaciteteve dhe veprimit të NJVNR nëpërmjet trajnimit dhe mentorimit.
2. Zhvillimi i modeleve praktike të punës
3. Zgjerimi i partneritetit dhe mekanizmave ndërsektoriale
4. Rritje e identifikimit të rasteve dhe reagimit të NJVNR ndaj nevojave të komunitetit
5. Ndërveprim i vazhdueshëm me institucione partnere si për identifikimin e rasteve, për menaxhimin dhe monitorimin tyre.

Bashkangjitur do të gjeni :

Analiza e nevoja që është bërë nga ekspertja ne bashkëpunim me Drejtorin e Shërbimit Social për nevojat e kësaj drejtorie e më gjerë;\

Planin e punës

Marrëveshjen e rilidhur për të rritur efektivitetin e Mekanizmit Kundër Dhunës në Familje.

Sa më sipër, duke vlerësuar hapat angazhimit institucional të marrë nga Bashkia Durrës, rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, duke vlerësuar hapat dhe angazhimit institucional të marrë nga bashkitë e mësipërme, rekomandimi në tërësi konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

4- Gjetje nga auditimi: Monitorimet e kryera nga Shërbimi Social Shtetëror duhet të kryhen në përputhje me metodologjinë e monitorimit të shërbimeve shoqërore. Nga auditimi është konstatuar se programet e monitorimit dhe më pas raportet janë formale, ato hartohen duke u fokusuar kryesisht në aspektin tematik - financiar të monitorimit të shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës në familje.

4.1 Rekomandimi: Shërbimit Social Shtetëror të rishikojë planet dhe programet e monitorimit, me qëllim që ato të jenë të detajuara për të garantuar përdorimin e duhur të fondeve kundrejt objektivave e rezultateve të projekteve sociale (strehëza) dhe mënyrën e realizimit të shërbimit të specializuar për të mbijetuarat e dhunës në familje për rehabilitimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 24.12.2024 Shërbimi Social Shtetëror ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Në bazë të planit të veprimit të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, janë hartuar planet dhe programet e monitorimit me objektiva më të specifikuar, për të garantuar përdorimin e duhur të fondeve kundrejt objektivave e rezultateve të projekteve sociale.

Sqarojmë se nga ana e U..... është realizuar trajnim mbi “metodologjinë e monitorimit të shërbimeve sociale” ku janë trajnuar Drejtoria e Shërbimeve Sociale në SHSSH dhe punonjësit socialë të Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Me miratimin e metodologjisë së monitorimit planet dhe programet do jenë më të specifikuar.

(Bashkëngjitur agjenda me dokumentin e metodologjisë së monitorimit realizuar nga U....)

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, duke vlerësuar masat e marra nga Shërbimi Social Shtetëror, pritshmërinë për miratimin e metodologjisë së re të monitorimit, por dhe afatit në vijimësi për zbatimin e rekomandimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi**.

1.3 Pyetje e auditimit: A janë përdorur kapacitetet njerëzore dhe financiare, etj., në mbështetje të sistemit ?

1- Gjetje nga auditimi: Megjithëse numri i rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare çdo vit arrin në rreth 5,000 raste, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe struktura e saj e varësisë Shërbimi Social Shtetëror nuk disponojnë ende një vlerësim të kapaciteteve akomoduese në rang kombëtar, për tu përgjigjur në kohë rasteve të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare. Ndërkohë, kapacitetet shtetërore paraqiten mjaft të limituara me rreth 32 shtretërisht të dedikuara në nivel kombëtar në qendrat rezidenciale dhe rreth 30 shtretër emergjence të disponueshëm në qendra multifunkionale, ku këto të fundit, ofrojnë akomodim dhe për problematika të tjera.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror, të kryej vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapaciteteve akomoduese shtetërore në vend dhe gjendjes së infrastrukturës ekzistuese, për të evidentuar në mënyrë të qartë dhe të plotë nevojat dhe alokuar në mënyrë të drejtë burimet për to.

Brenda datës 30.06.2024

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit (MSHMS)

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 06.01.2025 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Për këtë rekomandim është dhënë përgjigja nga Shërbimi Social Shtetëror.

MSHMS, përmbushjen e këtij rekomandimi MSHMS në Programin e Punës 20 ditor ia ka deleguar Shërbimit Social Shtetëror. Në informacionin e përcjellë nga SHSSH nuk evidentohen ende rezultatet e një vlerësimi mbi mjaftueshmërinë e kapaciteteve akomoduese shtetërore në vend. Për këtë rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit (SHSSH)

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 24.12.2024 Shërbimi Social Shtetëror ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

1. Shërbimi Social Shtetëror ka ndërvepruar me shkresë me nr.1086/4 prot, datë 07.05.2024 “kërkesë për informacion” me 12 drejtoritë Rajonale të SHSSH-së në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore për të vlerësuar mjaftueshmërinë e kapaciteteve akomoduese si dhe gjendjen e infrastrukturës ekzistuese në vend të shërbimeve për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Në vijim është realizuar informacioni dërguar MSHMS me nr. 7253 prot, datë 26.09.2024 mbi rekomandimin e lënë.

(Bashkëngjitur gjeni shkresën dërguar ZR të SHSSH-së dhe informacionin dërguar MSHMS)

2. Shërbimi Social Shtetëror në programin e miratuar nr.4409 prot datë 06.06.2024 për vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapaciteteve ekzistuese dhe gjendjen e infrastrukturës në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Dhunës në Familje realizoi vlerësimin nga grupi i punës dhe me shkresë nr.4405/1 prot, datë 11.06.2024 përcolli informacion në MSHMS. Sikurse me shkresë nr.4409/3 prot, datë 23.07.2024 dërgon për ndjekje QKTVDHF.

(Bashkëngjitur gjeni shkresat dhe informacionet si më lart cituar)

Nga ana e Shërbimit Social Shtetëror nëpërmjet Drejtorive Rajonale të DRSSH, është kryer evidentimi i strehëzave në vend dhe gjendjes së infrastrukturës në to. Ky informacion i përmbledhur është paraqitur në MSHMS. Nuk evidentohen ende rezultatet e një vlerësimi mbi mjaftueshmërinë e kapaciteteve akomoduese shtetërore në vend. Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, rekomandimi në tërësi konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

2- Gjetje nga auditimi: Fondi Social, si një mekanizëm relativisht i ri, mbështetës për bashkitë e vendit, sa i përket financimit të qendrave të trajtimit të dhunës në familje, nuk ka arritur të implementohet në mënyrë efektshme, për të garantuar vazhdimësinë e tyre të mëtejshme nga këto njësi të vetëqeverisjes vendore. Megjithatë projektet parashikojnë kriteret dhe standarde të parashikuara për një afat 3-vjeçar për ofrimin e shërbimeve, ato nuk arrijnë të përmbushen referuar aplikimeve të miratuara. Ndërkohë edhe financimet e kryera nëpërmjet Këshillave të Qarkut lidhur me dhunën në familje kanë evidentuar mangësi. Mangësitë konsistojnë kryesisht, në mungesën e planeve sociale rajonale të bashkërenduar me planet sociale të bashkive në territor, mos miratimi i kërkesave nga këshilli për projekte përpara paraqitjes së kërkesave për financim, mungesës së monitorimeve të vazhdueshme mbi dhënësit e shërbimit si dhe mungesa e raportimeve në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike në MSHMS dhe SHSSH për shërbimin e kontraktuar, kjo për të garantuar cilësinë e shërbimit dhe shpenzimin e fondeve në mënyrë efektive.

2.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror të kryej një auditim të plotë për Fondin Social të realizuar sa i përket dhunës në familje për vitet ushtrimorë 2020 - 2023, duke u fokusuar tek përfituesit kryesorë të tij, me qëllim verifikimin financiar të pagesave të kryera dhe shërbimeve faktike të ofruara dhe rezultatet e tij ti paraqesë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Brenda datës 31.10.2024

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 24.12.2024 Shërbimi Social Shtetëror ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Shërbimi Social Shtetëror ka realizuar monitorim për vitin 2023 në të gjitha qendrat të financuara nga fondi social, gjithsej 5 shërbime të ngritura, që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje. Shërbimi Social Shtetëror ka realizuar Raportin mbi vlerësimin e shërbimeve të mbështetura me Fond Social për vitin 2023 ku në këtë raport është dhe tipologjia për shërbimet e Dhunës ndaj Grave.

(Bashkëngjitur Raporti nr.1560/1 prot, datë: 08.11.2024, dërguar në MSHMS për shërbimet e financuara nga Fondi Social ku është dhe tipologjia për shërbimet e dhunës ndaj grave, si dhe programet dhe rezultatet e monitorimit në 5 shërbimet për mbrojtjen e grave-viktima të dhunës)

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

2.2 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të bëjë miratimin e projekteve të financuara nga Fondi Social vetëm pasi ato të jenë të miratuara më parë nga Këshilli i Qarkut së bashku me planet sociale rajonale të bashkërenduar me bashkitë përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 06.01.2025 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Lidhur me këtë rekomandim Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka filluar procesin e mbështetjes së Qarkut Korçë, si një qark pilot, për shkrimin e Planit Social Vendor, proces i cili do shtrihet gradualisht në të 12 qarqet e vendit.

Sqarojmë gjithashtu se në kuadër të Thirrjes për Fondin Social për vitin 2025, është përgatitur një Udhëzues lidhur me aplikimin e qarqeve, të publikuar në faqen zyrtare të MSHMS-së, ku qarqet janë udhëzuar që çdo kërkesë duhet të jetë aprovuar në Këshillin e Qarkut, kërkesë tashmë e zbatuar nga të gjitha këshillat e qarqeve.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, duke vlerësuar masat e marra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por dhe afatit në vijimësi për zbatimin e rekomandimit, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi**.

3- Gjetje nga auditimi: Bonusi i qirasë për viktimat e dhunës në familje gjendet në nivele minimale. Kështu në bashkitë e audituara, konkretisht në Bashkitë Durrës, dhe Gjirokastrë, evidentohen mesatarisht 2 deri në 3 përfitues në vit. Në Bashkinë Kukës mbështetja me bonus qiraje është ofruar nga organizatat jofitimprurëse, ndërkohë që kjo bashki nuk ka kryer asnjë

pagesë për këtë kategori. Sa i përket strehimit, situata mbetet thuajse njëloj ku Bashkia Durrës paraqitet me 4 raste strehimi social, ajo Gjirokastrë me 2 raste, ndërsa Bashkia Kukës pa asnjë rast të subvencionuar. Nivelet e ulëta të mbështetjes financiare nga këto njësi të vetëqeverisjes vendore jo pak të rëndësishme nga niveli i popullsisë dhe rasteve të regjistruara, paraqesin nevojën për një fokus më të qartë të tyre drejt grave, viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare.

3.1 Rekomandimi: Bashkia Kukës, Gjirokastrë dhe Durrës gjatë hartimit të projektbuxheteve vendore bazuar në numrin e aplikimeve për bonus qiraje të grave viktimave të dhunës në familje dhe problematikave sociale të territorit që mbulojnë, të marrin në konsideratë rritjen e numrit të subvencionimeve me bonus qiraje për këtë kategori.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me shkresën nr. 5550/1 prot., datë 14.01.2025 Bashkia Kukës ka përcjellë shpjegimet përkatëse. *Është marrë në konsideratë dhe për çdo aplikim apo kërkesë që mund të paraqitet në territorin e Bashkisë Kukës në ndërhyrje në buxhet.*

Duke vlerësuar rëndësinë që çështjet e strehimit kanë për viktimat e dhunës si dhe angazhimin institucional të marrë nga Bashkia Kukës, rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 18.12.2024 Bashkia Gjirokastrë ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Në përgjigje të rekomandimit nr. 3.1 fq.8, viktimat e dhunës kanë qenë prioritare në përfitimin nga programet e strehimit, si nga programi subvencion i interesave të kredisë edhe nga programi subvencion i vlerave të qerasë në tregun e lirë. Specifikisht për vitin 2024, kanë aplikuar 3 (tre) viktimat e dhunës për tu suportuar me bonus qiraje për gjatë vitit 2025. Komisioni i strehimit ka ofruar përparësi duke bërë të mundur që të tre aplikimet të jenë përfituese. Vendimi dhe listat përkatëse do të kalojnë për miratim në Këshillin Bashkiak, Gjirokastrë brenda datës 27 dhjetor 2024.

Sa më sipër, evidentohen masat e marra nga Bashkia Gjirokastrë. Duke vlerësuar rëndësinë që çështjet e strehimit kanë për viktimat e dhunës, mbetet për tu vlerësuar në vijim përmbushja e plotë e rekomandimit. Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Bashkia Durrës Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 27.12.2024 ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Në zbatim të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar, VKM nr. 459 datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njërive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njërive të vetëqeverisjes vendore dhe Ministrisë përgjegjëse për strehim” Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.574, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqes familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 814, datë 03.12.2004 “Për normat e Strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, janë miratuar Vendimet e Këshillit Bashkiak Durrës si më poshtë:

-Me V.K.B. nr. 25 datë 06.03.2024 “Për miratimin e listës emërore të familjeve që përmbushin kriteret ligjore për përfitimin e bonusit të strehimit që do të akordohet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në favor të Bashkisë Durrës për subvencionimin e qirasë për vitin 2024” ku janë trajtohen me bonus qiraje 193 familje

-Me V.K.B. nr. 109 datë 16.12.2024 “Për miratimin e listës emërore të familjeve që përmbushin kriteret ligjore për përfitimin e bonusit të strehimit që do të akordohet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në favor të Bashkisë Durrës për subvencionimin e qirasë për vitin 2024” ku janë trajtohen me bonus qiraje 94 familje

Programi social i strehimit për “Subvencionimin e qirasë për familjet që kërkojnë të përfitojnë nga bonusi për strehim” synon të mbështesë familjet që kanë në përbërjen e tyre familjare invalidë, komunitet rom, egjiptian, jetim, ish-pronarët, etj., pra shtresat më në nevojë, me qëllim përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës.

Familjet që janë trajtuar me bonus strehimi në bazë të VKB nga 2018 -2024

Nr.	VITET	V.K.B.	TOTALI	TOTALI nga buxhet SHTETIT	TOTALI nga buxhet Bashkisë	Kategoria sipas nenit 24 të ligjit nr.22/2018 , Anëtarët e minoritetit Rom	Kategoria sipas nenit 24 të ligjit nr.22/2018 , Anëtarët e minoritetit Egjiptian	Kategoria sipas nenit 24 të ligjit nr.22/2018 , Viktima të dhunës në familje
1	2018	VKB nr. 551 , Datë 25/10/2018	33 familje	1.689.040 lek		8 familje	12 familje	
2	2019	VKB nr.635 , Datë 11/10/2019	33 familje	2.268.000 lek		8 familje	12 familje	
3	2020	VKB nr. 4 , Datë 29/01/2020	62 familje	7.476.122 lek		11 familje	20 familje	
4	2021	VKB nr. 39 , Datë 31/03/2021	93 familje	13.816.200 lek		18 familje	21 familje	1 familje
5	2021	VKB nr.123 , Datë 24/12/2021	107 familje	7.816.200 lek	6.000.000 lek	24 familje	28 familje	
6	2022	VKB nr. 82 , Datë 26/07/2022	168 familje	8.886.928 lek	6.000.000 lek	29 familje	34 familje	1 familje
7	2023	VKB nr.179 , Datë 01/12/2023	185 familje	21.151.920 lek	6.000.000 lek	38 familje	50 familje	
8	2024	VKB nr.25 , Datë 06/03/2024	193 familje	29.884.306 lek		47 familje	62 familje	
9	2024	VKB nr.25 , Datë 06/03/2024	193 familje	4.740.125 lek		47 familje	62 familje	2 familje
10	2024	VKB nr.109, Datë 16/12/2024	94 familje		8.000.000 lek	16 familje	47 familje	

Ju bëjmë me dije se aplikimet për programet e Strehimit Social bëhet në çdo moment , në portalin e-albania , pranë dritares "Kërkesë për të përfituar nga programet e Strehimit social" , në të cilën ngarkohen të gjithë dokumentacionet e kërkuara referuar Ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin social" i ndryshuar .

Në Bashkinë Durrës kanë aplikuar deri sot 2750 familje për të përfituar nga programet e Strehimit social , nga të cilët 794 (shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) familje kanë aplikuar për të

përfituar kredi të lehtësuara për strehim me 3 % interes nga Shteti ,1639 (njëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë) familje kanë aplikuar për të përfituar banesë sociale me qira, si dhe 317 (treqind e shtatëmbëdhjetë) familje kanë aplikuar për të përfituar bonus strehimi.

Më sipër evidentohen masat e marra nga Bashkia Durrës. Duke vlerësuar rëndësinë që çështjet e strehimit kanë për viktimat e dhunës, mbetet për tu vlerësuar në vijim përmbushja e plotë e rekomandimit. Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, rekomandimi në tërësi konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

4- Gjetje nga auditimi: Qendrat shtetërore të ofrimit të shërbimeve për dhunën në familje, si ato të emergjencës ashtu edhe ato rezidenciale, nuk rezultonin të licencuara referuar kategorisë përkatëse të kuadrit ligjor që rregullon shërbimet komunitare dhe rezidenciale. Ky licencim duhet të kryhej rregullisht nëpërmjet QKB pas vlerësimit të përputhshmërisë së kriterëve dhe situatës në vend nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Mungesa e licencimeve të qendrave shtetërore mbart risk jo vetëm mbi përmbushjen e kriterëve të akomodimit dhe cilësisë së shërbimit të ofruar nga ana e tyre, por gjithashtu krijon një model aspak pozitiv për shoqatat apo dhe organizatat partnere të cilat ofrojnë shërbime dhe ndihmë për viktimat e dhunës në familje.

4.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masat e nevojshme që qendrat e ofrimit të shërbimeve për dhunën familje të pajisen me licencën përkatëse për ofrimin e shërbimeve, në zbatim të kuadrit ligjor për ofrimin e shërbimeve brenda standardeve, si dhe të trajtimit të barabartë të institucioneve publike me OJF dhe/ose ato private.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 06.01.2025 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Në shkresën dërguar Kontrollit të Lartë të Shtetit, me nr. 2006/7 dhe 2006/8, datë 23.01.2024, ku përcillet programi i punës për masat në zbatim të rekomandimeve të raportit përfundimtar të Auditimit të Performancës me temë “Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, me fokus gratë e dhunuara”, është ngarkuar Inspektorati përgjegjës për shërbimet sociale për zbatimin e rekomandimit, si institucioni përgjegjës për inspektimin e qendrave të përkujdesit shoqëror.

Informojmë se në kuadër të kontroleve periodike të inspektoratit të shërbimeve sociale, si dhe nga kontrollet e realizuara nga grupi i punës, i ngritur pranë MSHMS-së, pranë qendrave komunitare dhe qendrave të emergjencës për gratë viktime të dhunës në familje, u është lënë si rekomandim bashkive, kryerja e procedurave të licencimit të shërbimit, sipas legjislacionit në fuqi.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, megjithëse këtë rekomandim në Programin e Punës 20 ditor MSHMS ia ka deleguar Shërbimit Social Shtetëror, duhet të dispononte informacionin mbi ecurinë e licencimeve në këto qendra. Në mungesë të këtyre të dhënave rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.**

5- Gjetje nga auditimi: Sistemi REVALB i cili shërben për evidentimin e të dhënave të rasteve të dhunës në familje në rang kombëtar nuk është një aset i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e cila nuk dispononte gjithashtu informacion të mjaftueshëm lidhur me hostimin e tij. Ndërkohë që ky sistem mirëmbahet nga ekspertë jashtë MSHMS dhe përpunon të dhëna sensitive prej rreth 10 vitesh.

5.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ti drejtohet institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si autoriteti përgjegjës që mbikëqyr dhe monitoron, mbrojtjen e të dhënave personale, për vlerësimin e mënyrës së ruajtjes e përpunimit të të dhënave në këtë rast dhe garantuar mbrojtjen dhe përdorimin ligjor të tyre.

Menjëherë

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 06.01.2025 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Informojmë se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i është drejtuar me kërkesë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me shkresën me nr. protokollit 5181, datë 26.12.2024.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

6- Gjetje nga auditimi: Për periudhën nën auditim evidentohen mangësi lidhur me strukturat ekzistuese në institucionet qendrore, fushat e veprimit i të cilave lidhet me trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare. Konkretisht, strukturat e ngarkuara për politikën dhe barazinë gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pas ristrukturimit të kryer kanë pësuar ulje të numrit të stafit. Sektori përgjegjës në këtë ministri paraqitet me vetëm (1+2) punonjës duke pasur në vijimësi pozicione vakante, megjithëse ky sektor ka detyra mjaft të rëndësishme si në drejtim të hartimit të politikave dhe zhvillimin e tyre, koordinimin e mekanizmit, adresimin e çështjeve të dhunës etj. Ndërkohë Ministria e Drejtësisë nuk disponon ende një strukturë të posaçme e cila të koordinojë veprimtaritë për dhunën në familje, por këto detyra i janë ngarkuar aktualisht punonjësve të cilët janë përgjegjës për funksione të tjera.

6.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Drejtësisë të rishikojnë strukturat ekzistuese të cilat lidhen me çështjet të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, brenda kapaciteteve të tyre institucionale, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të ngarkuara dhe rritjen e efektivitetit të tyre në mekanizmin e ngritur.

Brenda datës 31.03.2024

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit (MSHMS)

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 06.01.2025 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Me Urdhër të Kryeministrit Nr. 205, datë 23.10.2024, Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është krijuar Drejtoria e Barazisë Gjinore, Tashmë, Drejtoria e Barazisë Gjinore ka në përbërje të saj dy sektorë, sektorin e Barazisë Gjinore dhe Sektori i Luftës ndaj Dhunës në Familje.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

Shpjegimet e subjektit të audituar mbi zbatimin e rekomandimit (MD)

Me përgjigjen e përcjellë nëpërmjet e-mailit datë 13.01.2025 Ministria e Drejtësisë ka paraqitur shpjegimet përkatëse.

Ministria e Drejtësisë, duke marrë në konsideratë faktin se MSHMS si Institucioni kryesor në këtë proces, ka ndryshuar dhe përforcuar së fundmi me ligj strukturën duke krijuar Sektor të posaçëm përgjegjës për çështjet e dhunës në familje dhe barazisë gjinore, do të rishikojë dhe ri-vlerësojë mundësinë e krijimit të një Pozicioni specialist apo Sektor Përgjegjës brenda kapaciteteve të saj institucionale në përputhje edhe me dinamikën në vijim të punës së orientuar nga MSHMS dhe koordinatorët e Bashkive.

Rekomandimi konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Sa më sipër, duke vlerësuar angazhimin institucional të marrë nga Ministria e Drejtësisë, dhe përmbushjen e rekomandimit nga ana e MSHMS, rekomandimi konsiderohet **i pranuar dhe në proces zbatimi.**

Trajtimi i observacioneve/komenteve të paraqitura nga subjektet e audituara.

Komente të paraqitura nga DPPSH

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën nr. 1466/1 prot, datë 17.03.2025, administruar në KLSH me nr. 1481/12 prot, datë 18.03.2025, ka paraqitur komente/shpjegime lidhur me Projektraportin e dërguar dhe konkretisht mbi statusin e rekomandimit e Pyetjes Audituese 1.2.1, seksioni “Masa Organizative”, nëpërmjet të cilit i rekomandohet DPPSH ngritja e një grupi pune për të vlerësuar krijimin e funksionit të dedikuar ndihmës/specialist për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, i cili rezultoi i zbatuar pjesërisht.

Nga ana e DPPSH evidentohet se, me riorganizimin e kryer në muajin Qershor 2023 ka ndryshuar planifikimi, menaxhimi dhe drejtimi i shërbimeve policore e cila tashmë bëhet mbi bazën e “Zonës Policore”. Në strukturat qendrore dhe vendore nivel DVP-je ka funksione të dedikuara vetëm për dhunën në familje të cilët janë të trajnuar për trajtimin e këtyre veprave. Në nivel komisarati ka specialistë/ndihmës për krimet të cilët mbulojnë dhe rastet e dhunës në familje sipas zonave policore.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

- Lidhur me komentet e paraqitura evidentojmë se, nga ana e DPPSH ka pasur ndryshime strukturore të cilat prekin edhe strukturat që lidhen me dhunën në familje, por rekomandimi i dhënë i referohet nevojës për një vlerësim mbi nevojën për funksione të dedikuara në komisarate detryra të cilat aktualisht mbulohen nga specialistët e seksionit të hetimit të krimeve në volum. Funksionet organike shef sektori dhe specialist për dhunën në familje në DVP janë funksione administrative dhe kanë rol koordinues/raportues brenda policisë në kuadër dhe të MKR, ndërsa funksioni ndihmës specialist/specialist për krimet është figura profesionale e cila ndeshet me rastin e dhunës në familje dhe nis procedurat për menaxhimin e tij. Në strukturën për periudhën vitet 2018-2023 në Komisaritet e Policisë, në varësi të territorit që mbulonin dhe numrit të ngjarjeve të evidentuara, ka pasur 1 deri 3 funksione organike “Specialist për hetimin e krimeve dhe për të miturit e dhunës në familje”, trajtuar më hollësisht në Raportin e Auditimit viti 2023.

Sa më sipër statusi i zbatimit të rekomandimit të lënë mbetet i pandryshuar.

Komente të paraqitura nga MSHMS

Drejtoria e Barazisë Gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka paraqitur komente/shpjegime të paraqitura me e-mail lidhur me një nga rekomandimet e paraqitura në Projektraportin e dërguar dhe konkretisht rekomandimin pjesë e Pyetjes Audituese 1.2.1, seksioni “Propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore”, i cili i referohet nevojës për ndryshimin e akteve ligjore me qëllim përfshirjen e shërbimit psikologjik gjatë fazës së trajtimit të riskut për viktimat e dhunës në familje.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

- Lidhur me komentet e paraqitura evidentojmë se, rekomandimi nuk është kundërshtuar nga ana e MSHMS në Planin e Masave 20 ditor pas dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit si dhe në raportimin 6-mujor trajton vijimin e procesit. Gjithashtu sqarojmë se, garantimi i vlerësimit psikologjik gjatë fazës së trajtimit të riskut është mjaft i rëndësishëm për viktimat e dhunës në familje, çka kërkon përmirësimin e kuadrit ligjor aktual në këtë drejtim. Sa më sipër nuk observimi nuk pranohet..

VI. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit, mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH të përcjella me shkresat nr. 442/25 prot., 442/26 prot., 442/27 prot., 442/28 prot., 442/29 prot., 442/30 prot., 442/31 prot., 442/32 prot., datë 22.12.2023., konstatohet se një pjesë e madhe e tyre paraqitet e zbatuar pjesërisht ose në proces zbatimi. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **ri-kërkojmë** zbatimin e rekomandimeve, si më poshtë:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1.1 Pyetje e auditimit: A kanë ndikuar pozitivisht masat parandaluese të marra për dhunën ndaj grave në marrëdhëniet familjare ?

1- Gjetje nga auditimi: Legjislacioni ka pasur mangësi në evidentimin e përgjegjësive të personave që janë pjesë e sistemit të MKR-së për masat parandaluese, por edhe për drejtuesit e pushtetit vendor që nuk përmbushin detyrimet ligjore për rehabilitim e viktimave të dhunës në familje si pjesë e mbrojtjes që parashikohet. Ka munguar gjithashtu bashkëpunimi ndër institucional i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Ministrinë e Brendshme dhe/ose Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për të evidentuar dhe marrë masat e nevojshme sensibilizuese të cilat kanë impakt të lartë social.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të marrin masa për të propozuar ndryshime ligjore ku të kërkohet ashpërsimi i legjislacionit, për vënien përpara përgjegjësive administrative dhe penale të përfaqësuesve të institucioneve qendrore e vendore, që nuk përmbushin detyrimet ligjore për parandalimin e dhunës në familje dhe masave mbrojtëse, në veçanti kur nga mosveprimet e tyre janë shkaktuar dëmtime të rënda në marrëdhëniet familjare ose viktimat.

Brenda datës 31.12.2025

1.2.1 Pyetje e auditimit: Si ka funksionuar përgjigjja dhe menaxhimi i rasteve të dhunës ndaj grave në marrëdhëniet familjare nga institucionet e përfshira?

2- Gjetje nga auditimi: Midis anëtarëve të Ekipit Teknik Ndërdisciplinor që trajton rastet e dhunës në familje dhe Koordinatorëve Vendor në bashki për referimin e rasteve të dhunës, ka munguar ndërveprimi dhe komunikimi i duhur zyrtar në dy drejtime. Së pari, strukturat vendore të policisë së shtetit nuk përcjellin (në të gjitha rastet që referojnë) raportin e vlerësimit të riskut pranë KVDH - së, për arsye se, sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje⁴, një kopje e raportit të vlerësimit të riskut i jepet, përveç titullarit të strukturës përgjegjëse (policisë) dhe punonjësve (kryesisht KVDH) që thirren për hartimin e këtij raporti. KVDH nuk ka detyrimin të jetë prezent gjithmonë në momentin e vlerësimit të riskut në polici. Së dyti, evidentohet se referimet e institucioneve të tjera anëtarë të ETN – së janë në nivele minimale, krahasimisht me policinë e shtetit.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale së bashku me Ministrinë e Brendshme të rishikojnë Udhëzimin e Përbashkët nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”, për të përcjellë në çdo rast raportin e vlerësimit të riskut koordinatorit vendor të dhunës në bashki.

Brenda datës 31.12.2025

3- Gjetje nga auditimi: Baza ligjore dhe rregullatore aktualisht në fuqi nuk parashikon ndërhyrjen e shërbimit psikologjik në fazën e hartimit të raportit të vlerësimit të riskut. VKM – ja për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, dy udhëzimet e përbashkëta të Ministrisë të Brendshme dhe Ministrisë të Shëndetësisë, si dhe Protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor përmes MKR – së, nuk parashikojnë ndërhyrjen e psikologut në fazën e hartimit të raportit të vlerësimit të riskut.

3.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masa për ndryshimet e nevojshme në bazën ligjore rregullatore për përfshirjen e vlerësimit psikologjik gjatë fazës së vlerësimit të riskut për viktimat e dhunës në familje.

Brenda datës 31.12.2025

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Pyetje e auditimit: A kanë ndikuar pozitivisht masat parandaluese të marra për dhunën ndaj grave në marrëdhëniet familjare?

1- Gjetje nga auditimi: Bazuar në treguesit e evidentuar konstatohet se në përmbushje të trajtimit sa më të efektshëm të çështjeve të dhunës në familje e dhunës ndaj grave në nivel vendor (bashkitë/njësitë e vetëqeverisjes vendore), konstatohet se vetëm 5 Bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan dhe Korçë), kanë hartuar Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore në përputhje me Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave, ndërsa bashkitë e tjera nuk kanë një Plan veprimi vendor për çdo bashki dhe shtrirjen e tyre në plan veprimi për ato Njësi Administrative që

⁴ Udhëzimi i Përbashkët nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”, Kreu II, pika 11.

janë me risk të lartë në mungesën e barazisë gjinore të ndikuar nga faktorë të ndryshëm territorial (Njësi administrative/Qark). Mungesa e këtyre Planeve veprimi vendore nuk përkon me detyrimin që kanë këto njësi vendore në zbatim të Strategjisë Kombëtare “Për Barazinë Gjinore dhe të Planit të Veprimit 2016-2020”, miratuar me VKM nr. 73, datë 20.10.2016 dhe Objektivin 3.1 “Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje” dhe Objektivin 4.4 “Ndërgjegjësimi i shoqërisë për pranimin e barazisë gjinore si kusht i domosdoshëm për zhvillimin e vendit”; dhe kërkesat e Strategjisë Kombëtare “Për Barazinë Gjinore dhe të Planit të Veprimit 2021-2030” miratuar me VKM nr. 400, datë 30.06.2021.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme të marrin masa, për të kërkuar nga të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (Bashki/Qark dhe Njësi Administrative) përgatitjen dhe miratimin në Këshillin Bashkiak/Qarkut të Planit të Veprimit vendor për barazinë gjinore dhe dhunën ndaj grave, duke përcaktuar sa më qartë hapat, strukturat e përfshira, fushat e bashkëpunimit me institucione shtetërore dhe organizata joqeveritare, institucionet vendore të arsimit etj., të përfshira në zinxhirin e ngritur nga momenti i referimit deri në zgjidhjen e problemit paraqitur si dhe të evidentohet qartë veprimtaria ndërgjegjëse e parandaluese në këtë drejtim.

Brenda datës 31.12.2025

1.2.1 Pyetje e auditimit: Si ka funksionuar përgjigjja dhe menaxhimi i rasteve të dhunës ndaj grave në marrëdhëniet familjare nga institucionet e përfshira?

2-Gjetje nga auditimi: Në strukturat vendore të Policisë së Shtetit ndihmës specialistët/specialistët e krimeve që kryejnë menaxhimin fillestar të rasteve të dhunës në familje nuk janë të dedikuar vetëm për këtë funksion. Policia e Shtetit, edhe pse i ka dhënë përparësi krijimit të këtyre funksioneve, ende nuk i jep rëndësinë e duhur këtij funksioni, siç edhe ka ndodhur në vende të tjera fqinje në rajonin tonë, ku kjo figurë është e dedikuar.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të ngrejë grup pune për të vlerësuar krijimin e funksionit të dedikuar specialist/ndihmës specialist për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

Brenda datës 31.12.2025

3- Gjetje nga auditimi: Në 37 bashki të vendit koordinatori vendor i dhunës nuk është i dedikuar për të mbuluar vetëm rastet e dhunës në familje. Në Bashkinë Gjirokastrë, KVDH për periudhën nëntor 2021 – e në vijim është alternuar nga pozicioni i KVDH në pozicionin e punonjësit administrativ të Qendrës Emergjente të Viktimave të Dhunës në Familje. Aktualisht KVDH ende rezulton si punonjës administrativ i kësaj qendre, por që mbulon edhe detyrën e KVDH – së në Bashkinë Gjirokastrë. Po kështu, në Bashkinë Kukës, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka vetëm një specialiste Punonjëse Sociale, e cila kryen edhe rolin e Koordinatorit Vendor për rastet e grave të dhunuara. Kjo bashki nuk ka aktualisht në strukturë një pozicion specifik Koordinator Vendor. Gjithashtu, rezulton se vitin e fundit në rang republike janë zëvendësuar 18 KVDH, të cilët duhet të ri - trajnohen për të kryer funksionet e tyre.

3.1 Rekomandimi: Bashkia Gjirokastrë të përfshijë në strukturën e saj Koordinatorin vendor të dhunës si funksion më vete, pa mbivendosje me funksione të tjera në fushën e barazisë gjinore.

Brenda datës 31.12.2025

1.2.2 Pyetje e auditimit: A ka funksionuar sistemi i raportimit, monitorimit të procesit?

4- Gjetje nga auditimi: Qendrat shtetërore të ofrimit të shërbimeve për dhunën në familje, si ato të emergjencës ashtu edhe ato rezidenciale, nuk rezultojnë të licencuara referuar kategorisë përkatëse të kuadrit ligjor që rregullon shërbimet komunitare dhe rezidenciale. Ky licencim duhet të kryhej rregullisht nëpërmjet QKB pas vlerësimit të përputhshmërisë së kriterëve dhe situatës në vend nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Mungesa e licencimeve të qendrave shtetërore mbart risk jo vetëm mbi përmbushjen e kriterëve të akomodimit dhe cilësisë së shërbimit të ofruar nga ana e tyre, por gjithashtu krijon një model aspak pozitiv për shoqatat apo dhe organizatat partnere të cilat ofrojnë shërbime dhe ndihmë për viktimat e dhunës në familje.

4.1 Rekomandimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masat e nevojshme që qendrat e ofrimit të shërbimeve për dhunën familje të pajisen me licencën përkatëse për ofrimin e shërbimeve, në zbatim të kuadrit ligjor për ofrimin e shërbimeve brenda standardeve, si dhe të trajtimin të barabartë të institucioneve publike me OJF dhe/ose ato private.

Menjëherë dhe në vijimësi

Të tjera

Për të gjitha masat e dhëna të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar me statusin ***në proces zbatimi***, duke vlerësuar proceset e ndërmarra nga subjektet e audituara dhe afatet e nevojshme për implementimin e plotë, kërkohet zbatimi i plotë i tyre **brenda vitit 2025**.

Për sa më sipër u mbajt ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT

V. Aneksi
Përmbledhëse e masave sipas llojit.

PËR AUDITIMIN ME TEMË: “Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus, gratë e dhunuara”

Në 000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE	Rekomandu ar gjithsej		Pranuar subjekti		Papranu ar subjekti		Shkalla e pranimit		Statusi i rekomandimeve të pranuara											
		Nr.	Vlera lekë	Nr.	Vler a	Nr.	Vl er a	Nr.	Vl er a	Zbatuar		Zbatuar pjesërisht		Proces zbatimi		Nga e cila		Pa zbatuar		Ne proces gjyq	
										Nr.	Vler a	Nr.	Vlera	Nr.	Vler a	Arkëtu ar	Mbetj a	Nr.	Vler a	Nr.	Vler a
1	Masa për ndryshim apo përmirësim legjislativ	3		3				100%				3									
2	Masa organizative	21	-	21	-	-	-	100%		3		4		14							
3	Masa shpërblim dëmi																				
4	Masa për eliminimin e paligjshmërisë ..																				
5	Për eliminimin e efekteve																				
6	Masa disiplinore																				
7	Masa Administrative																				
TOTALI		24	-	24	-	-	-	100 %		3		7		14					-	-	-

